



Nr. _____ Prot

Tirane/12/2015

RELACION

**MBI LENIEN NE FUQI TE VENDIMEVE NR .139, NR.140, NR 141,
NR. 145, NR. 146, NR.147, NR.148 DATE 26.12.2014 SI DHE TE
VENDIMIT NR.27 DATE 16.02.2015 TE BORDIT TE
KOMISIONEREVE TE ERE-S PER PERIUDHEN 1 JANAR 2016-30
QERSHOR 2016.**

Bordit

Ne zbatim te ligjit nr. 43 /2015 “Per sektorin e energjise elektrike” dhe akteve te tjera nenligjore ne fuqi, ERE duhet te perfundoje procesin e perditesimit dhe rishikimit te tarifave te perdorimit te rrjetit te transmetimit, te perdorimit te rrjetit te shperndarjes se energjise elektrike sipas niveleve te tensionit dhe cmimeve te shitjes me pakice te energjise elektrike per kategorine e klienteve ne kuader te sherbimit publik per vitin 2016.

Ketij qellimi i ka paraprire komunikimi yne i hershem vecanerisht me OSHEE sh.a.me qellim arritjen e objektivave per liberalizimin e tregut ne zbatim te Ligjit 43/2015 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”.

Ne nenin 109 piken 3 te ketij ligji percaktohet qe klientet e lidhur ne tensionin 35kV jane te detyruar te dalin ne tregun e liberalizuar jo me vone se data 31 dhjetor 2015, klientet e lidhur ne tensionin 20 kV, jo me vone se data 31 dhjetor 2016 ndersa kliente e lidhur ne nivelin e tensionit 10 kV dhe 0.6 kV, jo me vone se data 31 dhjetor 2017.

Realizimi i ketij detyrimi kushtezohet nga percaktimi i drejte i tarifave te aksesit per nivelet perkatese te tensionit.

ERE, me vendimin nr.146 date 26.12.2014 te Bordit te Komisionereve miratoi tarifen e aksesit vetem per nivelin e tensionit 35 kV, ndersa percaktimi i tarifes per

nivelet e tjera te tensionit do te behej ne vijim.Percaktimi i tarifes se aksesit per konsumatoret ne 35 kV per vitin 2015 u mbeshtet ne nje varg supozimesh per alokimin e kostove per shkak te pamundesise OSHEE sh.a. per te paraqitur informacion te sakte teknik, ekonomik dhe financiar bazuar ne evidentimin e shpenzimeve ne menyre te ndare sipas niveleve te tensionit.

Per sa me lart,ERE me shkresen nr. 307 Prot. date 23.03.2015drejtuar OSHEE sh.a. theksoi nevojën e paraqitjesne vazhdimesite informacionit te nevojshem teknik, ekonomik e financiar per percaktimin e tarifave te perdorimit te rjetit per nivelet respektive te tensionit.

OSHEE sh.a.,ne pergjigjigjen e saj me nr. 6818/1 Prot. date 18.05.2015, informoi se po punonte per pergatitjen e te dhenave paraprake mbi kostot e pritshme dhe nderkohe parashtrori nje sere argumentash e faktoresh qe, sipas kompanise e benin te pamundur ndarjen e kostove sipas aktiviteve te licensuara dhe niveleve te tensionit per aktivitetin e shperndarjes, te tilla si: struktura aktuale organizative e shoqerise, problematikat e trasheguara lidhur me regjistrimin e asetëve, sistemi i trasheguar i evidentimit kontabel, koha e pamjaftueshme etj.

Ne shkresen tone me nr 307/2 date 10.06.2015(derguar per dijeni edhe Ministrit te Energjise dhe Industries) j'u be e njohur OSHEE sh.a. se ndarja e llogarive sipas aktiviteve te licensuara dhe nivele te tensionit eshte detyrim ligjor, te cilin ERE kerkon qe te zbatohet dhe nderkohe, e nxiti kompanine te fillonte sa me shpejt punen per kete qellim duke i ofruar njekohesisht (ne menyre te perseritur) edhe ndihmen e bashkepunimin e saj. Per sa me lart nuk ka pasur reagim nga ana e kompanise.

Nderkohe, ERE me shkresen nr 567 Prot. date 3.09.2015 drejtuar KESH sh.a., OST sh.a dhe OSHEE sh.a.kerkoi qe keto kompani te paraqisnin brenda nje kohe sa me te shkurter aplikimet per tarifate per vitin 2016, pasi konstatohej qe ishte superuar prej tyre afati per aplikim i percaktuar ne *“Rregullat e praktikës dhe procedurat e ERE-s”* qe eshte dt 01.09.2015.ERE rekomandoi qe, nisur nga fakti qe nje sere aktesh nenligjore te parashikuara ne Ligjin 43/2015 nuk jane hartuar, keto aplikime duhet te permbushnin kriteret e percaktuara neaktet nenligjore ekzistuese si *“Rregullat e Praktikës dhe Procedurave te ERE-s”*, kerkesat e metodologjive perkatese sipas aktiviteve si dhe *“Kerkesat per Aplikim”*.

Ne pergjigjen e KESH sh.a. me shkresen nr 8007/1 date 30.09.2015 informohej se paraqitja nga ana e kompanise e aplikimit per rishikimin e tarifave dhe cmimeve per vitin 2016 ishte e pamundur per arsyet ne vijim;

- Ligji i ri Nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjise Elektrike” nuk parashikon funksion te Furnizuesit Publik me Shumice, te cilin aktualisht e kryen KESH sh.a. sipas percaktimeve te nenit 25 te ligjit te shfuqizuar nr 9072 date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”
- Mungojne aktekt nenligjore dhe rregullatore ne zbatim te ligjit te ri Nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjise Elektrike” qe percaktojne qarte detyrat dhe funksionet e secilit prej pjesmarresve te tregut te energjise elektrike, si dhe detyrimet per ofrimin e sherbimit publik.Ligji 43/2015 në nenin 108 të tij I ka lënë ERE-s dhe organeve përgjegjëse si Këshilli I Ministrave MEI-it apo të licencuarit sipas parashikimeve të ligjit, një afat prej 12 muajsh per hartimin dhe miratimin e këtyre akteve nga ERE.
- Institucionet pergjegjese per rregullimin e sektorit nuk kane nxjerre udhezimet perkatese se si do te mund te aplikohet rregjimi i tarifave per shoqerine KESH sh.a. per vitin 2016, duke respektuar parashikimet e ligjit Nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”.
- Me përfundimin e afatit të vendimeve ekzistuese nr .139, nr.140, nr 141, nr. 145, nr. 146, nr.147, nr.148 date 26.12.2014 dhe vendimit nr.27 date 16.02.2015, pjesemarresit e tregut, do të gjendeshin pa tarifa dhe çmime për shitjen e energjisë elektrike.

Nderkohe, nga ana e OSHEE sh.a.dhe OST sh.a. nuk pati reagim ne lidhje me kerkesen e ERE- s per aplikim.

Duke u ndodhur para kesaj suate, EREme shkresen nr. 567/3 Prot, date 23.10.2015 j’u drejtua perseri kompanive dhe mbështetur në parashikimet e Nenit 10 pika 2 të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” per dijeni ministrit te Ministrise se Energjisë dhe Industrise duke i bere te njohur se vendimet e Bordit te Komisionereve për përcaktimin e tarifave dhe cmimeve per vitin 2015 si dhe vendimet perkatese per miratimin e Planit te Investimeve te operatoreve perkates, shtrijnë efektin juridik deri me **31.12.2015** dhe per kete aresye kerkoi paraqitjen nga ana OSHEE sh.a, OST sh.a dhe KESH sh.a te:

- Te dhena ne lidhje me perditesimin e tarifes per periudhen aktuale (2015)
- Planit e Investimeve per vitin 2016
- Aplikimit për tarifat per vitin 2016 sipas aktiviteteteve te licensuara.

ERE kerkoi qe paraqitja e këtyre aplikimeve te ishte e plote e ne perputhje me kuadrin nenligjor ekzistues ne menyre qe te mundësohej analiza dhe vlerësimi i te Ardhurave te Kerkuara te kompanive per vitin 2016.

Ne kete shkrese vihet ne dukje se, për qëllime te implementimit te ligjit nr 43/2015, ne dispozita te veçanta (neni 109, pika 5 dhe 110 pika 2) eshte përcaktuar se:

" Të drejtat dhe detyrimet ekzistuese të pjesëmarrësve të tregut vazhdojnë të përmbushen nga ana e tyre deri në miratimin e akteve nënligjore, sipas parashikimeve të këtij ligji"

"Aketet nënligjore, që rregullojnë veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja, në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj".

Per sa me siper, j'u kerkua kompanive qe aplikimet perkatese te bazohen ne kuadrin rregullator te cituar me siper.

Ne kete shkrese u kerkua qe keto kompani te dergojne aplikimet per tarifa jo me vone se data **31 tetor 2015**, pasi procesi i shqyrtimit, analizes dhe rishikimit te tarifave dhe cmimeve nga ERE-s sipas *Rregullave te Praktikës dhe Procedurave ERE* i nënshtrohet nder te tjera një konsultimi te gjere me palët, përfshirë këtu edhe organizimin e seancave dëgjimore te cilat jane pjese e proceseve te ERE para vendimmarrjeve qe krijojnë një marrëdhënie te re juridike ne tregun e energjisë elektrike.

Sikurse eshte e njohur, cmimet perkatese per vitin 2015 per cdo kompani u percaktuan duke u bazuar ne metodologjite perkatese por duke mos marre parasysh axhustimet e periudhes rregullatore paraardhese, gje qe ishte e pamundur ne situaten kur detyrimet e ndersjellta midis paleve ishin ne shifra te konsiderueshme. Ne momentin e percaktimit te tarifave per vitin 2015, nisur edhe nga komunikimet zyrtare me MEI, u ra dakort qe keto detyrime te ndersjellta do te ishin subjekt i nje iniciative ligjore ne fillim te vitit 2015 per strukturimin e tyre.

Per sa me lart, ERE por edhe mbështetur në parashikimet e Nenit 10 pika 2 të ligjit 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" për t'i paraprire procesit te rishikimit te tarifave per vitin 2016, i drejtohet Ministrit te Energjisë dhe Industrisë me shkresen Nr. 420 Prot. date 22.05.2015 ku solli ne vemendje edhe nje here problemin e detyrimeve te ndersjellta ndermet kompanive te rregulluara te sektorit te energjise elektrike.

Duhet vene ne dukje se, kjo shkresë ishte ne vijim te shkresave te meparshme te ERE-s nr.767, prot date 2.12.2014 dhe 767/1 prot, date 18.12.2014, ku eshte kërkuar nder te tjera prej ministrise për zgjidhjen e problemit te shuarjes se detyrimeve te ndërsjellta midis palëve.

Nisur nga rendesia qe ka zgjidhja e ketij problemi per procesin e rishqyrtimit te tarifave te shërbimit për aktivitetet e rregulluara, vecanerisht ne drejtim te zbatimit te detyrimit ligjor per pasqyrimin e korrjimeve per periudhat e mëparshme, kjo ne funksion te detyrimit për transparence me konsumatorët, ERE shtronte nevojën e **“një vendimmarrje nga institucionet pergjegjese ne rolin e pronarit, por edhe atë të politikbërësit, ne lidhje me shuarjen apo veprimet e tjera ne kuadër te detyrimeve te ndërsjellta te këtyre kompanive për periudhat e mëparshme 2011-2014,** ne mënyrë qe te mund te procedohej me tej nga ana e ERE-s me rishikimin e te ardhurave te kërkuara vetëm për vitin 2016.

Gjithashtu,ERE nepermjeshkreses nr. 584. Prot, date 25.09.2015 ju drejtua Ministrise se Industrise dhe Energjitikes, Ministrise se Zhvillimit Ekonomik Turizmit Tregtise dhe Siper marrjes dhe Ministrise se Financave ku i njihite me veshtiresite ne percaktimin e tarifave dhe cmimeve per vitin 2016 si vijon:

- Megjithë kerkesen e perseritur te ERE-s, asnjë prej operatoreve publikë nuk ka paraqitur aplikimet per rishikimin e tarifave përkatëse per vitin 2016. Kjo eshtë e lidhur nder te tjera me përmbushjen e detyrimeve te ligjit te ri te sektorit e lidhur veçanerisht me Modelin dhe hapjen e tregut te energjisë e cila përfshin dhe një periudhe transitore te nevojshme për transferimin e aktivitetit te FPSH te Furnizuesi Publik me Pakice.
- Nuk eshte perfunduar procesi i mbylljesse detyrimeve te ndërsjella qe eshte një problematikë e mbartur që nga viti 2012 për te cilën referuar VKM nr. 126, date 11.02.2015 ka filluar procesin e shuarjes me kompensim te detyrimeve te ndërsjella të shoqërive të sektorit energjetik. Ky eshtë një proces kompleks qe kerkon kohe për evidentimin, rakordimin, shlyerjen dhe kompensimin e tyre.

Ne vlerësim te ERE-s, mbylla e procesit te nisur sipas VKM nr. 126 date 11.02.2015 eshtë ngushtësisht i lidhur me procesin e axhustimit te tarifave për periudhën paraardhëse cila reflektohet ne tarifat e periudhës pasardhëse (2016).

- Mospërcaktimi i formules së cmimit të shitjes së energjisë elektrike nga PVE krijon vështirësi për vlerësimin e ardhurave të kërkuara për Furnizuesin Publik i cili ka detyrimin e blerjes së energjisë nga keta prodhues. Kosto e blerjes së energjisë elektrike nga PVE përben një pjesë të konsiderueshme në koston totale të blerjes së energjisë elektrike për konsumatorët tariforë.

Duke ditur që VKM nr.125, datë 11.02.2015 ‘Për miratimin e metodologjisë të përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, për vitin 2015, që do t’i paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet’ ka përcaktuar metodologjinë e përcaktimit të tarifave fikse të energjisë për vitin 2015 nga kjo kategori prodhuesish, me perfundimin e afatit të vendimit Nr 27 Të Bordit të Komisionerëve të ERE, datë 16.02.2015 në datë 31 dhjetor, Prodhuesit e kësaj kategorie do të gjendëshin në kushtet e një çmimi të papërcaktuar mbi të cilin të operojnë. Vendimmarrja e ERE për përcaktimin e tarifës së prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2016 kushtëzohet nga miratimi i akteve të tjera nënligjore (sikurse ishte VKM nr. 125, datë 11.02.2015). ERE nëpërmjet shkresës Hyrëse Nr Prot 740 Datë 22.10.2015 u njoh me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 1033 Datë 16.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave fikse të energjisë që do t’i paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga Hidrocentralet” vendim i cili hyn në fuqi pas botimit në fletorë Zyrtare. Në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave i cili i shtrin efektet e tij për vitin 2016, në nenin 2 të tij është parashikues edhe se ERE ngarkohet me detyrimin për të saktësuar se cili do të jetë cmimi i shitjes së energjisë së prodhuar nga prodhuesit e vegjël të energjisë për periudhën e ndërmjetme deri në daljen e një cmimi që do të aplikohet për vitin 2016

Për sa më lart dhe më qëllim që vendimmarrja e mundshme e Bordit të ERE-s të reflektojë pikërisht ekuilibrimin e interesave të kompanive/konsumatorit /dhe shtetit, ERE në këtë shkresë thekson nevojën e bashkëpunimit për zgjidhjen e kësaj situatë.

Ligji nr. 138/2013 “Për burimet e rinovueshme” përcakton në nenin 15 pika 1 të ligjit, se: *Këshilli i Ministrave, me propozim të ERE-s, miraton metodologjinë e përcaktimit të tarifave fikse të energjisë elektrike, që do t’i paguhet prodhuesit me përparësi, për të gjitha llojet e centraleve, që shfrytëzojnë burime të rinovueshme energjie.* Ndërsa në nenin 15 pika 3 përcaktohet se, *ERE, në përputhje me metodologjinë e hartuar për tarifën fikse, çdo fund viti, miraton vlerat përkatëse të tarifave fikse, që duhet të paguhen për prodhuesit me përparësi, duke i*

ndarë ata në tre grupe për hidrocentralet: grupi i parë: nga 0 deri në 2000 kW, grupi i dytë nga 2001 deri në 5000 kW dhe grupi i tretë nga 5001 deri në 15000 kW.

Per sa me siper cituar si dhe pergjate punes per hartimin e metodologjise per llogaritjen e cmimit nga centralet qe shfrytesojne burimet e rinovueshme te energjise, jane ndeshur disa paqartesi te cilat ERE i ka bere me dije ne shkresen nr 638 prot. date 28.10.2015 drejtuar Ministrise se Energjise dhe Industrise:

Përcaktimi i subjekteve që duhet t’u adresohet kjo metodologji dhe për rrjedhojë edhe vendimet përkatëse të tarifave. Ligji nr.138/2013 “Për burimet e rinovueshme”, ka përcaktuar në gërmën rr) të nenit 3, si “Prodhues që kanë përparësi” *çdo prodhues te energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme me fuqi te instaluar deri ne 15 MW për te gjitha centralet e ndërtuara prej shoqërisë, i cili përfiton nga i) mekanizmi i tarifës fikse te shitjes (feed-in tariff) dhe ii) qe kane nënsbkruar marrëveshje për blerjen e energjisë (PPA) me kompaninë qe ka detyrimin te blejë energjinë elektrike te prodhuar nga burimet e rinovueshme.*

- Disa prej subjekteve qe jane licensuar ne perputhje me kontratatat e koncesionit per ndertim dhe shrytezimin e HEC-eve, rezultojnë të kenë në koncension centrale, të cilat e kalojnë limitin e përcaktuar në Ligji nr. 138/2013 “Për burimet e rinovueshme” evidentuar kjo edhe nga KESH sh.a. në korrespondencën mbi këtë problematikë.

Këto subjekte kanë të përcaktuar në kontratën e koncesionit ndër të tjera, të drejtë për t’i shitur energji KESH sh.a me çmime të rregulluara, metodologjia e llogaritjes së çmimeve për të cilët tanimë është e papërcaktuar duke ditur që Ligji nr. 138/2013 “Për burimet e rinovueshme”, adreson llogaritjen e tarifës për kategorinë e prodhuesve nga centralet deri ne 15 MW. Po ashtu është e rëndësishme të saktësohet nëse, subjektet mbajtës të kontratave koncesionare e përfitojnë statusin prodhues me përparësi, automatikisht për efekt të këtyre kontratave apo më parë duhet t’i nënshtrohen një procedure kualifikimi siç përcaktohet në Ligjin nr.138/2013 “Për burimet e rinovueshme”.

- Llogaritja e tarifës sipas grupeve paraqet problematika nisur nga fakti që subjekte të ndryshme që kanë marrë në koncesion më shume se një central, shpesh vihen në punë në intervale kohore të ndryshme, çka ndikon në rigrupimin dhe si të tillë në rillogaritjen e tarifës brenda vitit, ndërkohë që tarifat vendosen një herë në vit.

Ndarja e grupimeve siç është përcaktuar ne nenin 15 pika 3, është e lidhur me saktësimin nëse çmimi do të përcaktojë kostot për çdo impiant të burimeve të rinovueshme apo si grup impiantesh të përfaqësura nga shoqëria operuese ç'ka automatikisht do të ndryshonte rezultatet e llogaritjes së tarifës përfaqësuese për secilin grup.

- Gjithashtu ne nenin 15 pika 3 paragrafi i fundit i ligjit përcaktohet se: *“Tarifat fikse, për hidrocentralet sipas grupeve, aplikohen me të njëjtën vlerë edhe për të gjithë llojet e tjera të BRE”*, ndërkohë që ne piken 5 të nenit 15 përcaktohet se: *“Formula e mëposhtme zbatohet nga ana e ERE për të bërë të mundur përcaktimin e tarifës fikse për secilën teknologji të BRE*”
Kjo e bën konfuze llogaritjen e tarifës, pasi brenda të njëjtit nen paraqiten dy menyra të ndryshme të përcaktimit të tarifës për teknologji të ndryshme të burimeve të rinovueshme.
- Neni 14 i Ligji nr. 138/2013 “Për burimet e rinovueshme” përcakton detyrimin e Furnizuesit Publik me Shumice për blerjen energjisë elektrike nga Prodhuesit që kanë përparësi për një afat maksimal prej 15 vjetësh. Aktualisht shume prej subjekteve që prodhojnë energji nga burimet e rinovueshme (mbajtës të kontratave të koncesionit) kanë një periudhë disa vjeçare që operojnë me tarifa të rregulluara nxitëse. Si të tilla mbetet për tu saktësuar nëse afati i përcaktuar deri në 15 vjet fillon të llogaritet me futjen në operim të impiantit prodhues apo me afatin e futjes në fuqi të këtij ligji.
- Ligji po ashtu në nenin 3 pika 1 germa u, parashikon që kjo tarifë do të paguhet nga Konsumatorët Fundorë në përputhje me Modelin e Tregut. Në kuptim të akteve ligjore në fuqi, Ligji nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, përcakton si Klientë fundorë të gjithë konsumatorët që përdorin energjinë elektrike për përdorim vetjak, një koncept ky që gjendet edhe në Modelin e Tregut. Për sa me sipër duhet të sqarohet nëse kostot e energjisë nga BRE do të paguhet si me parë nga FPSH apo nga Operatori i Tregut, OST, OSHEE, apo Furnizuesi Universal duke përfshirë këtu edhe furnizuesit e tjerë që furnizojnë klientët në treg të parregulluar.

Per shkak të problematikave të mesiperme, bërë prezente edhe me herët nga ERE, u procedua me ndryshimet në Ligjin nr.135/2013 për shtyrjen e miratimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr.138/2013, “Për burimet e energjisë së rinovueshme”. Ky rregullim zhvendosi në kohë afatin e zbatimit të ligjit për burimet e rinovueshme por nga ana tjetër nuk zgjidhi problematiken që lidhet me

implementimin e këtij ligji për efekt të përcaktimit të tarifave nga Burimet e Rinovueshme.

ERE nëpërmjet shkresës Hyrëse Nr Prot 740 Datë 22.10.2015 u njoh me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 1033 Datë 16.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave fikse të energjisë që do t’i paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga Hidrocentralet” vendim i cili hyn në fuqi pas botimit në fletore Zyrtare. Në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave i cili i shtrin efektet e tij për vitin 2016, në nenin 2 të tij është parashikues edhe se ERE ngarkohet me detyrimin për të saktësuar se cili do të jetë çmimi i shitjes së energjisë së prodhuar nga prodhuesit e vegjël të energjisë për periudhën e ndërmjetme deri në daljen e një çmimi që do të palikohet për vitin 2016. Ne vijim, VKM Nr 1033 i dates 16.12.2015 “ Per miratimin e metodologjise se percaktimit te tarifave fikse te energjise, qe do tu paguhen prodhuesve te energjise elektrike nga hidrocentralet” vendos perseri formulen :

“Çmimi i shitjes (lekë/kWh) = Çmimi mesatar i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent /kWh X koeficientin 1.24 X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit.

Vendimi percakton se deri në miratimin e çmimit të shitjes së energjisë së prodhuar nga prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike sipas këtij vendimi për vitin 2016, ERE merr masa që të përcaktojë një çmim që do të aplikohet për një periudhë të ndërmjetme, **në zbatim të vendimit nr.125, datë 11.2.2015**, të Këshillit të Ministrave. Diferencat që mund të rezultojnë, ndërmjet çmimit të miratuar për vitin 2016 dhe çmimit të miratuar për periudhën e ndërmjetme, do të sistemohen nëpërmjet korigjimit të faturimeve përkatëse.

Per sa i takon problemit te aplikimit per tarifa nga tre kompanite publike,dhe duke u nisur nga fakti qe para sektorit ka nje sere problematikash te pazgjidhura sikurse paraqitur pergjate ketij relacioni dhe per faktin se ishin shkelur te gjitha afatet kohore te nevojshme per te zbatuar procedurat e parashikuara ne “Rregullat e praktikës dhe procedurat e ERE-s”,ERE me shkresen nr 678 date 23.11.2015 i kerkoitre kompanive publikeqeqe, ne zbatim të Ligjit Nr.43, datë 30.04.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” neni 20, gërma "d" per qellim te analizave dhe vleresimeve ne drejtim te realizimit te te ardhurave dhe kostove te aktivitetet e licensuara dhe pritshmerive per periudhen e mbetur deri ne fund te vitit 2015 te paraqesin prane ERE-s te dhena mbi realizimin e treguesve teknik, ekonomik e financiare per periudhen Janar-Tetor 2015.

Pervec informacionit te mesiperem, kompanive ju kerkua te paraqisnin ne ERE gjithashtu pritshmerite e tyre ne lidhje me realizimin e treguesve teknike,

ekonomike e financiare te kompanise per gjithë vitin 2015. ERE kerkoi qe informacioni i kerkuar te paraqitejsa me i plote, i detajuar dhe i shoqeruar me shpjegimet dhe argumentat e nevojshme brenda dates 27 Nentor 2015.

Kesaj kerkese te ERE-s ju pergjigj vetem OST sh.a me shkresen nr. 6897 Prot. date 3.12.2015.

Ne pergjigje te shqetesimeve te mesiperme te ERE-s, Ministria e Ekonomise dhe Industrise me shkresen nr 7094/5 prot, date 2.12.2015 shprehu qendrimin si me poshte:

Ne kuader te garantimit te hapjes se tregut ne zbatim te ligjit nr. 43/2015, Ministria e Energjise dhe industrise, me ndihmen e Sekretariatit dhe te partnereve si USAID, Qeveria e Norvegjise, BE, po punon per hartimin e akteve nenligjore, brenda afateve te percaktuara ne kete ligj.

Me ndihmen e konsulenteve te Nord Pool, ka nisur te zhvillohet ideja e krijimit per Bursen e Energjise se Shqiperise, duke mbeshtetur idene se, ne vendet e rajonit tone me nje treg te vogel individual, eshte i domosdoshem organizimi i nje tregu rajonal, per te rritur eficencen e gjenerimit ne drejtim te reduktimit te kostove ne interes te konsumatoreve. MEI vlereson si sfida ceshtjet qe lidhen me sa me poshte:

- Hartimi i Tregut te Energjise, ku perfshihet nje periudhe tranzitore per te transferuar aktivitetin e FPSH te Furnizuesi Publik me Pakice, pjese e OSHEEsh.a.
- Mbyllja e detyrimeve te ndersjella i cili eshte nje proces kompleks i iniciuar me VKM nr. 126 date 11.02.2015 dhe qe nderkohe kerkon kohe per evidentimin, rakordimin, shlyerjen dhe kompensimin e tyre.
- Vleresimi i te ardhurave te kerkuara te Furnizuesit Publik i cili ka detyrimin e blerjes se energjise nga PVE-te si pasoje e mospercaktimit te formules se cmimit te shitjes se energjise elektrike nga keta prodhues.

Ne keto kushte, ne periudhen aktuale tranzitore te hartimit te akteve nenligjore dhe rregullatore perkatese, kryerja e nje analize dhe vleresimi per te ardhurat e kerkuara nga ana e seciles prej kompanive publike, KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. eshte lidhur me llogaritjen e kostove te operimit per te permbushur aktivitetin ne perputhje me kriteret qe percakton ligji, si dhe perditesimin e tarifes per periudhat e meparshme rregullatore qe eshte e pamundur te behet si pasoje e situates financiare te trasheguar, e cila eshte reflektuar tek marredheniet e ndersjellta midis tre operatoreve. Gjithashtu, vazhdon procesi per rakordimin e

detyrimeve midis paleve dhe aksioni i iniciuar nga Qeveria per permbushjen e objektivaveper rritjen e performances se kompanive ne perputhje me Planin e Rimekembjes se Sektorit te Energjise, e cila do te percaktoje objektivat/targetet e kompanive publike per periudhen e ardhshme rregullatore.

Nga ana e shoqerive KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. eshte raportuar se fundmi ne MEI (shkresat bashkelidhur), **se te ardhurat e realizuara mbi bazen e tarifave aktuale te miratuara nga ERE per vitin 2015, mundesojne aktivitetin ne kushte normale per 6-mujorin e pare te vitit 2016.**

Duke patur ne konsiderate sa me siper, ne funksion te ushtrimit te detyrave si institucioni pergjegjes per hartimin e politikave te sektorit te energjise elektrike, MEI vlereson se shtrirja e efekteve te tarifave dhe cmimeve aktuale deri ne fund te 6-mujorit te pare te vitit 2016, si dhe shtyrja e procesit te aplikimeve te kompanive per kete periudhe, do sherbente ne kryerjen e nje analize me te sakte te vleresimit te te ardhurave te kerkuara te kompanive, ne perputhje me objektivat e cituar me siper.

Informacioni qe tre kompanite publike kane paraqitur ne MEI dhe derguar ne ERE bashkengjitur shkreses se MEI-t nr 7094/5 prot. date 2.12.2015, si dhe informacioni i OST me nr.6897/1 prot. date 3.12.2015 nuk i ploteson kerkesat e per kryerjen e nje analize te plote nga ana e ERE-s ne perputhje me metodologjite perkatese te llogaritjes se tarifave. Nderkohe konstatohet se te tre kompanite parashikojne te kene rezultat pozitiv per vitin 2015, ku vecanerisht spikat OSHEE sh.a. me nje fitim prej rreth 8.9 miliard leke nga aktiviteti ose rreth 6.4 here me shume nga sa i eshte pranuar kesaj kompanie ne tarifate e vitit 2015. Pa permendur ketu edhe 3.8 miliard leke te ardhura te jashtezakonshme te cilat vijne nga efekti i VKM Nr 126 date 11.2.2015 “Per percaktimin e shumave te shuarjes me kompensim, te detyrimeve ndermjet institucioneve buxhetore dhe jo-buxhetore qe financohen nga Buxheti, KESH sh.a., OSHEE sh.a. dhe Ministrise se Financave” dhe VKM nr. 482 date 23 qershor 2015 “Per fillimin e procedurave per kalimin dhe shuarjen me kompensim te detyrimeve ndermjet KESH sh.a, OSHEE sh.a. dhe disa banoreve te permbytur ne zonen e Shkodres”. Performanca e mire e kesaj kompanie ne drejtim te uljes se humbjeve dhe rritjes se nivelit te arketimeve qe ne kombinim me faktore te tjere kane sjelle nje rezultat financiar te tille, kane bere te mundur qe OSHEE sh.a. te kryej ne masen 116% pagesat per detyrimet ndaj OSTsh.a per periudhen Janar-Tetor 2015 dhe ne masen e percaktuar ne Planin e Rimekembjes per KESHsh.a (s’ka info.) Kjo ka bere te mundur permiresimin e gjendjes ne likuiditete te OST sh.a. e KESH sh.a. e per rrjedhim te kryerjes se pagesave te detyrimeve prej tyre duke i dhene frymemarrje sektorit.

Situata e permiresuar, e konstatuar per sa na lejon informacioni, megjithese jo i plote qe kemi ne dispozicion, con ne perfundimin se tarifat per vitin 2015 kane gene te mjaftueshme qe kompanite te mund te zhvillojne aktivitet normal e te mund te realizojne rezultat financiar pozitiv.

Per sa me siper dhe ne kushtet kur:

- Hartimi i akteve nenligjore dhe rregullatore perkatese ne perputhje me Ligjin 43/2015 nuk ka perfunduar.
- Mbyllja e detyrimeve te ndersjella midis tre operatoreve eshte ende ne proces rakordimi dhe ende nuk ka perfunduar.
- Tre kompanite publike nuk kane paraqitur Planet e Investimeve per vitin 2016.
- Tre kompanite publike nuk kane paraqitur aplikimet per rishikimin e tarifave perkatese per vitin 2016.
- Konstatohet nje situatë e permiresuar e sektorit qe sherben si indikator i mjaftushmerise se tarifave te vitit 2015 per kryerjen e nje aktiviteti normal nga tre operoret.
- Ministria e Ekonomise dhe Industrise si dhe tre kompanite publike jane shprehur pro shtrirjes se efektit te tarifave dhe cmimeve aktuale per 6/mujorin e pare te vitit 2016.

-

Bazuar ne nenin 10 pika 2, 16, 20 si dhe piken 5 te nenit 109 te Ligjit 43/2015 “Per sektorin e energjise elektrike” dhe nenit 15 pikat 1 dhe 3 te Ligji nr. 138/2013 “Për burimet e rinovueshme” i propozojme Bordit te Komisionereve lenien ne fuqi deri ne date 30 qershor 2016, te tarifave te miratuara perkatesisht me vendimet si me poshte:

- Vendimin nr. 139, date 26.12.2014 “Per percaktimin e tarifes se prodhimit te energjise elektrike nga KESH sh.a. per vitin 2015”.
- Vendimin nr. 140, date 29.12.2014 “Per percaktimin e tarifes se energjise elektrike per Furnizuesin Publik me Shumice per vitin 2015”.
- Vendimin nr. 141, date 26.12.2014 “Per percaktimine tarifes per sherbimet ndihmese te KESH sh.a. per vitin 2015”.

- Vendimin nr. 145, date 26.12.2014 “Per miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. vitin 2015”.
- Vendimin nr. 146 datë 26.12.2014 “ Për përcaktimin e tarifës të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2015 në nivelin e tensionit 35 kV”.
- Vendimin Nr.147, date 26.12.2014 “Per përcaktimin e tarifës mesatare të shërbimit të shpërndarjes të energjisë elektrike për vitin 2015” dhe
- Vendimin Nr.148 date 26.12.2014 “Per përcaktimin e cmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015”.

Ne lidhje me tarifën fikse të energjisë që do të paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet propozojmë bazuar në pikën 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave datë 16 dhjetor 2015, i propozojmë bordit të ERE :

Fuqia juridike e Vendimit Nr. 27 Të Bordit të Komisionerëve të ERE, datë 16.02.2015 “Mbi miratimin e tarifës fikse të energjisë për vitin 2015, që do të paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet, zgjatet deri në marrjen e vendimit të shfuqizimit të tij nga Bordi i ERE

Me hyrjen në fuqi të Vendimit të Këshillit të Ministrave mbi “Metodologjinë e përcaktimit të tarifave fikse të energjisë që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga Hidrocentralet”, për vitin 2016, dhe publikimit të Raportit vjetor (Physical futures Annual report) nga bursa e Hungarisë HUPX për vitin përkatës, ERE do të shprehet me vendim “Mbi miratimin e tarifës fikse të energjisë për vitin 2016, të prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”,

Perditesimi dhe kompesimi i të gjitha efekteve të mundshme financiare për të licensuarit do të bëhet brenda vitit 2016.

Punuan : Lavdie Konjari

Kunderfirmoi : Raimonda Islamaj, Erjola Sadushi, Orjana Kallaku, Agim Nashi